

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Ardian DVORANI	Kryesues
Arjana FULLANI	Anëtare
Andi ÇELIKU	Anëtar

Mori në shqyrtim në dhomë këshillimi të datës 10.05.2017, çështjen administrative që i përket:

PADITËS: **Artil Marku;**

I PADITUR: **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;**

OBJEKTI: *Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërbleje me një vit page për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës të paditur të dëmshpërbleje me 2 muaj page për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Detyrimin e palës të paditur të dëmshpërbleje me 2 muaj page për shkak të pagës që do kishim përfituar nëse do të ishte respektuar afati njoftimit.*

BAZA LIGJORE: *Nenet 141 140; 143; 144; 155 “K.Punes”. Neni 7/ç 17/g të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 3269 datë 17.06.2014 ka vendosur: *“Pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që t’i paguaje paditësit Artil Marku pagën deri në fund të afatit të njoftimit. nga data 15/12/2013 -28/02/2014. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që t’i paguaje paditësit Artil Marku një dëmshpërblim në masën e 10 (dhjete) muajve page për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që t’i paguaje paditësit Artil Marku dëmshpërblim në masën e 2 (dy) muajve page për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur. Ky vendim ekzekutohet nga Zyrat e Përmbartimit pasi të marre forme të prera”.*

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2425 datë 16.11.2015 vendosi: *“Ndryshimin pjesërisht të Vendimit Nr.3269 Dt. 17.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të dëmshpërbleje paditësin Artil Marku me 1 (një) muaj page, për mosrespektim të afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës; Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të dëmshpërbleje paditësin Artil Marku me 3 (tre) muaj page, për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës; Lënien në fuqi të*

vendimit për disponimet e tjera; Shpenzime gjyqësore ne Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen”.

Kundër vendimit nr. 2425 datë 16.11.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe pala paditëse Artil Marku ...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 63 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr. 2425 datë 16.11.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 3269 datë 17.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë, më 10.05.2017

**Nr. 31003-00826-00-2016 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-1559 i Vendimit (513)**